

Marrëveshje Gjithëpërfshirëse apo Menaxhim të Konfliktit

Hyrje

Këshilli për Qeverisje Gjithëpërfshirëse (CIG) organizoi më 2 shkurt 2020 një punëtori në Graçanicë, Kosovë, për disa analistë kosovarë dhe serbë. Analistët analizuan zhvillimet e fundit në dialogun mes Kosovës dhe Serbisë, duke u fokusuar në domethënjen e "Letrave të Synimit" për të vendosur linjë ajrore dhe hekurudhore mes Beogradit dhe Prishtinës. Pjesëmarrësit mirëpritën çdo përparim në procesin e normalizimit, por ishin skeptikë që "letra" të tilla paraqesin ndonjë përparim thelbësor dhe se një marrëveshje përfundimtare mund të arrihet së shpejti. Qeverisë së re në Kosovë do i duhet kohë për të konsoliduar institucionet e saj ndërsa Serbia do të jetë e zënë me zgjedhjet e planifikuara në prill 2002.

Dy dekada pas luftës, Kosova dhe Serbia mbeten të bllokuara nga një mosmarrëveshje statusi që gjithnjë e më shumë duket e pazgjidhshme. Prishtina kërkon njohje të pakushtëzuar nga Serbia. Beogradi nuk e përjashton njohjen por kërkon diçka në këmbim, mundësisht pjesë të territorit të Kosovës. BE nuk ka një pozicion zyrtar për njohjen, duke pasur parasysh që brenda BE-së ka pesë anëtarë që nuk e njohin Kosovën, dhe nuk duket se ka një plan për një të ashtuquajtur normalizim gjithëpërfshirës. Shtetet e Bashkuara kanë mandatuar Ambasadorin e SHBA në Gjermani Richard Grenell që të merret me konfliktin Kosovë-Serbi. Strategjia e Ambasadorit Grenell nuk është e qartë. A ka hequr dorë nga një marrëveshje gjithëpërfshirëse duke adresuar nga një çështje në një kohë, siç është linja ajrore dhe hekurudhore, duke u fokusuar më shumë në menaxhim të konfliktit, apo po përpiqet të përgatisë terrenin përmes këtyre marrëveshjeve për një marrëveshje përfundimtare paqeje?

Të tri "Letrat e Synimit" nuk janë juridikisht të detyrueshme. Këto letra thjesht përshkruajnë një marrëveshje në parim midis dy palëve për të ecur përpara me këto plane. Analistët dhe ekspertët thonë se ekzistojnë shumë pengesa politike dhe ligjore në rrugën drejt zbatimit. Sidoqoftë, presidentët Aleksandar Vucic dhe Hashim Thaçi si dhe Ambasadori Grenell po i promovojnë këto letra si marrëveshje dhe "fitore historike". Për më tepër, nuk ka asnjë angazhim financiar për të zbatuar këto marrëveshje. Për shembull, 30 kilometra linjë hekurudhore mungojnë në anën e Kosovës dhe ndërtimi i tyre do të kushtonte rreth 300 milion euro. Nga ana serbe, linja hekurudhore poashtu mezi i plotëson kushtet për përdorim. Shumë njerëz pyesin nëse kjo është thjesht një lloj publiciteti për marrëdhëniet me publikun për Grenellin, Vuçiçin dhe Thaçin apo ata me të vërtetë ata kanë një plan për të zbatuar këto 'qëllime.' Poashtu, nuk ka asnjë plan kohor për zbatimin e këtyre 'marrëveshjeve'. Nëse dikush ka menduar se marrëveshjet e Brukselit ishin të paqarta, atëherë ata duhet t'i lexojnë këto "Letra të Synimit", tha një folës.

Sidoqoftë, krahasuar me dialogun në Bruksel, i ashtuquajhuri 'procesi Grenell' duket më efikas, duke supozuar se marrëveshjet do të zbatohen. Sidoqoftë, shumë janë skeptikë për objektivat dhe angazhimin e procesit Grenell. Shumë i shohin ato si përpjekje për të fituar pikë për administratën amerikane përpara zgjedhjeve presidenciale të nëntorit sesa si hapa që çojnë drejt një zgjidhjeje gjithëpërfshirëse. Disa thanë që Ambasadori Grenell njohu realitetin; që njohja dhe ndarja nuk janë të mundshme, kështu që ai u kthye në adresimin e çështjeve që janë më pak të ndjeshme.

Prishtina duket se ka lëvizur nga parimi i saj i deklaruar se "nuk do të pajtohem për asgjë derisa të pajtohem për gjithçka" tek parimi "të le të pajtohem për atë që mundemi," shpjegoi një analist. Sidoqoftë, qeveria e re nuk e ka përcaktuar strategjinë e saj të dialogut akoma. SHBA dhe BE nuk kanë një strategji të përbashkët. Ambasadori Grenell po udhëheq një proces të pavarur pa u këshilluar me BE-në, pa një strategji të qartë dhe afatgjatë, kryesisht duke folur për zhvillimin ekonomik. Nga ana tjetër, shefi i ri i politikës së jashtme të BE-së Josep Borrell deklaroi gjatë vizitave në Prishtinë dhe Beograd se objektivi i tij është të arrijë një marrëveshje përfundimtare që përfshin njohjen dhe se Serbia nuk ka perspektivë të BE-së pa e njohur Kosovën.

Përgatitja për marrëveshje

Ekziston një numër hapash që Prishtina dhe Beogradi mund të ndërmarrin përderisa dialogu zyrtar mbetet i bllokuar. Pjesëmarrësit thanë që kushtet për të arritur një marrëveshje përfundimtare nuk ekzistojnë, por mundësi për normalizim ka. Më poshtë është një listë e hapave që analistët sugjerojnë që duhet të ndërmirren nga Beogradi dhe Prishtina.

Heqja e barrierave të udhëtimit. Prishtina dhe Beogradi duhet të rivlerësojnë dhe azhurnojnë marrëveshjen e Brukselit për të udhëtuar lirshëm. Beogradi duhet të pezullojë pengesat administrative – dokumentet e përkohshme të udhëtimit dhe targat e përkohshme të makinave - për kosovarët. Prishtina duhet të përfshihet në të ashtuquajturën Iniciativa Ballkanike Mini-Schengen që ka për qëllim krijimin e një zone të tregtisë së lirë në Ballkan.

Zbatimi i Marrëveshjes së Integruar të Menaxhimit të Kufijve. Beogradi dhe Prishtina duhet të zbatojnë plotësisht marrëveshjen e IBM. Zbatimi i marrëveshjes duhet të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur dhe autoritetet serbe duhet të lëvizin në ndërtesat e reja në Merdare.

Pezullimi i tarifës doganore dhe fushatës së çnjohjes. Prishtina duhet të pezullojë tarifën e saj doganore 100 % ndaj mallrave serbe dhe Beogradi duhet të pezullojë fushatën për çnjohjen e Kosovës dhe të ndalojë pengesën për anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare. Prishtina nuk duhet të imponojë masa reciprociteti pa bashkëpunim dhe koordinim të ngushtë me bashkësinë ndërkombëtare.

Të arrihet një marrëveshje për liberalizimin rajonal të vizave. Përderisa vendet e Ballkanit negociojnë për një zonë të lire të tregtisë, ata duhet që menjëherë të heqin barrierat e udhëtimit për njëri-tjetrin. Të gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor duhet të njohin dokumentet e njëri-tjetrit, si dhe Kosova dhe Bosnja dhe Hercegovina duhet t'i heqin vizat mes vete. Vendet e tjera

duhet të ndihmojnë Prishtinën dhe Sarajevën të arrijnë një marrëveshje të tillë. Të gjashtë vendet e Ballkanit gjithashtu duhet të llobojnë tek BE-ja për të hequr vizat për Kosovën.

Angazhimi në masa për ndërtimin e besimit. Prishtina dhe Beogradi duhet të promovojnë dhe angazhohen në aktivitete për ndërtimin e besimit, përfshirë vizitat zyrtare të politikanëve në kryeqytetet e njëri-tjetrit, komunikim më të dyanshëm ndërmjet partive politike dhe parlamenteve, pjesëmarrjen e zyrtarëve në ngjarje joformale dhe të përmbahen nga veprimet e njëanshme që dëmtojnë dialogun.

Udhëheqja e debateve të brendshme për marrëveshje përfundimtare. Qeveria e Kosovës dhe ajo e Serbisë duhet të organizojnë debate të brendshme zyrtare dhe joformale për një marrëveshje përfundimtare që synon të ndërtojë mbështetje të brendshme dhe aktualitet. Qeveria e Kosovës sapo është formuar dhe ka një mandat të plotë për t'u rikuperuar nga dëmet eventuale afatshkurtra nga pakënaqësia e publikut ndaj dialogut. Serbia do të ketë një qeveri të re deri në verë. Ky është një konfigurim ideal për t'u përfshirë në bisedime që synojnë të arrijnë zgjidhje afatgjata që tejkalojnë ciklet e zgjedhjeve. Është e rëndësishme të përfshihen palët opozitare si në debate ashtu edhe në procesin e bisedimeve.

Të funksionalizohet fondi për Veriun. Qeveria e Kosovës duhet të aktivizojë Fondin për Veriun që është lënë prapa, dhe të mbështesë projekte investimesh në të katër komunat në veri. Një menaxhim i suksesshëm dhe transparent i Fondit mund të rrisë mbështetjen e katër komunave për qeverinë e re dhe të përmirësojë marrëdhëniet e përgjithshme ndëretnike në Kosovë. Do të kontribuonte gjithashtu në dialogun e brendshëm të shpallur nga qeveria me komunitetin serb. Në të njëjtën kohë, komuniteti serb në Kosovë dhe Lista Serbe duhet të angazhohen më shumë për çështjet lokale, duke ua lënë mosmarrëveshjen Beograd-Prishtinë niveleve më të larta politike.

Pyetje pa përgjigje. Pjesëmarrësit e punëtorisë patën një numër pyetjesh në lidhje me dialogun dhe marrëveshjen e ardhshme: A është ideja e shkëmbimeve të territoreve e harruar apo thjesht ka humbur momentumin e saj? A mund të ketë një marrëveshje pa njohje dhe çfarë do të thotë për të ardhmen e marrëdhënjeve? Si do të dukej një marrëveshje pa njohje? A e lë një marrëveshje pa njohje – modeli i dy Gjermanive – konfliktin të hapur? A mund të arrihet një marrëveshje me njohje por pa shkëmbime territori? Sa e rëndësishme është njohja nga Serbisë për Kosovën? A mund të zgjidhen çështje të tjera pa status përderisa palët presin një kohë më të mirë për të përfunduar statusin?

Pjesëmarrësit e punëtorisë nuk presin negociata serioze para zgjedhjeve në Serbi të planifikuara më 27 prill dhe formimit të Qeverisë së re. Ata gjithashtu dyshuan se zbatimi i dy "Letrave të Synimit" për linjën ajrore dhe hekurudhore mund të zbatohet në çfarëdo kohe. Sidoqoftë, ata rekomanduan që Prishtina dhe Beogradi të vazhdojnë angazhimet që përmirësojnë jetën e përditshme të njerëzve, si p.sh. udhëtimi i lirshëm, njohja e diplomave universitare dhe dokumenteve të tjera, si dhe normalizimi i marrëdhënieve të përgjithshme ndërsa presin kushte më të mira për një marrëveshje përfundimtare paqeje.